



Albanian-American
Development Foundation



**KONKURSI I PRANIMIT
NË
FAKULTETIN E ARKITEKTURËS DHE
URBANISTIKËS**

Vitin akademik 2022 – 2023

VARIANTI 0

Kodi i Sekretimit:

1) Nqs dy pika A dhe B ndodhen në një plan S, vijëdrejta që kalon nga këto dy pika :

- A) është pingul me planin S. B) ndodhet në planin S.
C) ndërpritet me planin S. D) është paralel me planin S.

2) Gjatë viteve 1945-1975, Blloku Perëndimor pati një zhvillim të madh ekonomik dhe shoqëror. Disa nga arsyet e këtij zhvillimi janë në pohimet e mëposhtme. Gjeni alternativën e gabuar.

- A) U ul numri i punonjësve jakëblu
B) U zgjeruan dallimet klasore
C) Iu dha fund ideologjive totalitare
D) U rrit numri i punonjësve në sektorin e shërbimeve

3) Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë përbëhet nga:

- A) 9 anëtarë B) 12 anëtarë C) 5 anëtarë D) 7 anëtarë


4) Një marangoz ngul 2 gozhdë në minutë e çdo minutë më pas dyfishon numrin e gozhdëve të ngulura. Sa gozhdë ka ngulur mbas 8 minutash?

- A) 90 B) 256 C) 85 D) 128

5) Një kub është i përbërë nga 125 kubikë të vegjël të bardhë të barabartë me njëri tjetrin. Nëse lyejmë me ngjyrë kubikët e vegjël në brinjët e kubit, sa kubikë të vegjël ngelen të bardhë?

- A) 45 B) 81 C) 54 D) 72

6) Llogarisni sa është sipërfaqja e trapezit kënd-drejtë ABCD:








- A) 452.25 B) 340 C) 285 D) 413.5

7) Një punëtor e hap një vrimë në beton me trapan elektrik për 5 minuta dhe po të njëjtën me trapan manual për 20 minuta. Ai fillon punën me trapan elektrik por mbas 2 minutash i prishet e vazhdon me trapan manual. Sa kohë do i duhet të përfundojë punën me trapan manual?

- A) 10 minuta B) 18 minuta C) 12 minuta D) 15 minuta

8) Cili nga gurët e dominosë zgjidh ekuacionin?



- A)  B) 
- C)  D) 

9) Në një zyrë me 60 persona harxhojnë 6 lapsa në ditë. Nëse në muajin gusht 1/3 e stafit janë me pushime, atëherë sa lapsa do harxhojnë në atë muaj për 5 ditë?

- A) 30 lapsa B) 20 lapsa C) 5 lapsa D) 15 lapsa

10) Iliri nisët nga shtëpia me biçikletë në drejtim të shtëpisë së Albës në të njëjtën kohë kur Alba nisët me këmbë në drejtim të shtëpisë së Ilirit. Duke ditur që të dy bëjnë të njëjtën rrugë dhe Iliri me biçikletë ecën me shpejtësi 20 km/h ndërsa Alba ecën me këmbë me shpejtësi 6 km/h e që të dyja shtëpitë janë larg rreth 13 km, mbas sa kohe do të takohen të dy sëbashku?

- A) Tre çerek ore B) Një çerek ore C) Një orë D) Gjysëm ore


11) Cili nga numrat e mëposhtëm korrespondojnë me brinjët e një trekëndëshi?





- A) 2, 3, 6 B) 3, 4, 6 C) 7, 14, 21 D) 1, 2, 3

12) Gjeni numrin që mungon në vargun 562, 281, 282, 141, 142 ...

- A) 36 B) 143 C) 72 D) 71

13) Cila figurë kompletion serinë?




- A)  B) 
- C)  D) 

14) Në një muaj të vitit për 3 ditë e marta bie në datë çift. Në cfarë dite bie data 19 në po atë muaj të vitit?

- A) E enjte B) E martë C) E premte D) E shtunë

15) Nga figura më poshtë në formë drejtkëndëshi hiqet pjesa e pakuadruar. Cila është përqindja e sipërfaqes së mbetur?



- A) 75% B) 80% C) 70% D) 60%

16) Gjeni numrin që mungon:

5	10	6	9
3	15	8	10
9	11	5	?

- A) 4 B) 45 C) 25 D) 15

17) Nëse:

$$x = 4 + y$$

$$y + z + \Omega + y = 11$$


$$z + 3 = \Omega$$





$$y + \Omega = x$$

Atëherë 'x' është e barabartë me:

- A) 7 B) 1 C) 4 D) 5

18) Cila figurë kompletton serinë?



- A)  B) 
- C)  D) 

19) Modelin e shoqërisë ideale, të quajtur "Qyteti i Diellit", e krijoi filozofi:

- A) Montenji B) Kampanela C) Akuini D) Dekarti

20) Lufta e parë Botërore, e cila filloi në vitin 1914 me pretekstin e vrasjes së princit Franc Ferdinandit, përfundoi në vitin:

- A) 1917 B) 1919 C) 1921 D) 1918

21) Kontinenti evropian ndahet nga ai afrikan nga një ngushticë e gjatë 14 km, e cila quhet:

- A) Ngushtica e Gjibraltarit B) Ngushtica e Beringut
C) Ngushtica e Dardaneleve D) Kanali i Suezit

22) Marrëveshja Shengen, sipas së cilës mallrat, kapitalet dhe fuqia punëtore kalojnë pa pengesë nga njëri shtet i BE në tjetrin, ka hyrë në fuqi në vitin:

- A) 1957 B) 1995 C) 2000 D) 1990

23) Cila prej veprave të mëposhtme nuk ka për autor Ismail Kadare?

- A) Darka e gabuar B) Dosja H
C) Pallati i ëndrrave D) Kronikë e një vdekjeje të paralajmëruar

24) Vepra e cilit kompozitor është shndërruar në himnin e Bashkimit Evropian?

- A) Giuseppe Verdi B) Richard Strauss
C) Wolfgang Mozart D) Ludwig van Beethoven

25) Shkolla e parë shqipe për vajza u hap nga:

- A) Thoma Papapano B) Pandeli Sotiri C) Sevasti Qiriazhi D) Musine Kokalari

26) Shteti me sipërfaqen më të madhe prej 238 391 km² në Ballkan është:

- A) Turqia evropiane B) Greqia C) Rumania D) Sllovenia

27) Berna është kryeqyteti i:

- A) Zvicrës B) Irlandës C) Luksemburgut D) Lihtenshtajnit

28) Cili prej kombinimeve vepër - autor është i saktë?

- A) Obelisku i zi - Stefan Zweig B) Lëkura e qenit - Ismail Kadare
C) Viti 93 - Viktor Hygo D) Fabula rasa - Rudi Erebura

29) Rryma filozofike e Skepticizmit ka për bazë të saj:

- A) Arsyen B) Ekuilibrin C) Moralin D) Dyshimin

30) Cili prej artistëve të mëposhtëm nuk është aktor?

- A) Martin Scorsese B) Marlon Brando C) Quentin Tarantino D) George Clooney

31) Lidhja Shqiptare e Prizrenit u themelua në Prizren në vitin:

- A) 1912 B) 1899 C) 1878 D) 1787

32) *"Kur më shihni se jam tretur/ mos pandehni se kam vdekur/ jam i gjall' e jam ndë jetë/ jam në dritët të vërtetë"* Cili është autori i këtyre vargjeve?

- A) Lasgush Poradeci B) Ndre Mjeda
C) Naim Frashëri D) Andon Zako Çajupi

33) Qendra e Principatës së Arbërit ishte:

- A) Kruja B) Shkodra C) Berati D) Durrësi

34) Gjeni personazhin që nuk i përket kategorisë:

- A) Botiçeli B) Mikelanxhelo C) Rafaeli D) Makiaveli

35) Gjeni personazhin që nuk i përket lëvizjes politike e kulturore iluministe:

- A) Kant B) Bekaria C) Volter D) Hegel


36) Shqipëria u njoh si principatë autonome, sovrane dhe e trashëgueshme nën garancinë e Fuqive të Mëdha. Ky vendim u mor në:

- A) Kongresin e Manastirit
B) Konferencën e Ambasadorëve në Londër
C) Kongresin e Berlinit
D) Traktatin e Shën Stefanit

37) Gjeni alternativën e gabuar. Reformat e Tanzimatit gjatë viteve 1839-1876, për rimëkëmbjen e Perandorisë Osmane:

- A) Nuk njihnin pronën private
B) Garantonin sigurinë e jetës dhe pronës pa dallim feje dhe kombësie
C) Mbështeteshin në kodet dhe ligjet franceze
D) Synonin sistemin arsimor jo fetar

38) Piktura e mëposhtme është realizuar nga:



- A) Pikaso B) Da Vinçi C) Kandiski D) Klimt

39) Gjej kombinimin e gabuar artist - lëvizje artistike:

- A) Kolë Idromeno — Rilindje Shqiptare B) Piter Pol Rubens — Ekspresionizëm
C) Pablo Pikaso - Kubizëm D) Francesko Borromini — Barok

40) Perandoria Romake u nda në dy pjesë në vitin 395, me vdekjen e Perandorit:

- A) Konstanci II B) Diokleciani C) Konstandini I D) Teodosi I

41) Lufta civile amerikane u zhvillua:

- A) në gjysmën e dytë të shekullit të XVIII B) në gjysmën e parë të shekullit të XVIII
C) në gjysmën e parë të shekullit të XIX D) në gjysmën e dytë të shekullit të XIX

42) Vendosni në rend kronologjik ngjarjet e mëposhtme:

1. Sulmi në Pearl Harbour 2. Kongresi i Vjenës 3. Konferenca e Jaltës 4. Traktati i Gaetës

- A) 4312 B) 4213 C) 2431 D) 3421

43) Shkëputja politike e SHBA me Britaninë e Madhe u sanksionua në Deklaratën e Pavarësisë, në vitin:

- A) 1787 B) 1865 C) 1861 D) 1776

44) Revolucioni i parë industrial e ka origjinën në:

- A) ShBA B) Francë C) Angli D) Itali


45) Lufta midis Spartës dhe Athinës njihet ndryshe me emrin:

- A) Lufta e Athinës B) Lufta e Mikenës
C) Lufta Persiane D) Lufta e Peloponezit

46) Cili stil artistik është zhvilluar përpara shekullit të XX:





- A) Konstruktivizmi B) Ekspresionizmi C) Ekletizmi D) Arti nuovo

47) Koni i prerë me planin P, krijon figurën gjeometrike :



- A) parabol. B) hiperbolë. C) trekëndësh. D) elips.

48) Cila nga alternativat është projeksioni në ballor V i objektit të dhënë në projeksionin horizontal ?



49) Cila nga figurat e prezantuara ka një ose më shumë akse simetrie?:








A) 1 - 2






B) 2-4

C) 2-3 D) 1-3


50) Cila nga alternativat është projeksioni në horizontal H i objektit të dhënë ?




51) Është dhënë projeksiioni në anësor W i një grup objektesh. Zgjidhni alternativën e saktë të projeksionit në horizontal H të tyre.




52) Përcaktoni alternativën e saktë të figurës së ndërprerjes, të trupit me planin që kalon nga pikat A, B,C,D.



A)



B)




C)



D)

53) Cila nga alternativat është paraqitja me projeksione, për figurën gjeometrike të dhënë në aksonometri ?




- A) A) B)
- C) C) D)

54) Në shkallën 1:5 në cilën përmasë do vizatohej segmenti 70cm?


- A) 10 cm B) 14 cm C) 12 cm D) 7.14 cm

55) Cila nga alternativat është paraqitja me projeksione për pikën e dhënë në aksonometri ?




- A)
- B)
- C)
- D)

56) Sa është kuota horizontale në sheshpushim, në panimetrinë e dhënë të shkallëve ?




- A) +1.53 B) -4.59 C) -2.61 D) +6.12

57) Sa është lartësia e një këmbe shkalle në prerjen e dhënë, kur lartësia e katit është 3.06m ?






- A) 17 cm B) 18 cm C) 18.5 cm D) 17.5 cm

58) Në figurë është dhënë kubi i paraqitur në :





- A) Izometri kalorsiake. B) Izometri horizontale.
C) Dimetri anesore. D) Dimetri horizontale.

59) Cila nga alternativat është paraqitja me projeksione, për segmentin e dhënë në aksonometri ?



A)



B)




C)

D)


60) Cili nga katër objektet në aksonometri korespondon me paraqitjen me tre projeksione në ortogonal ?




A)



B)



C)



D)

- 1) B
- 2) B
- 3) A
- 4) B
- 5) B
- 6) D
- 7) C
- 8) C
- 9) B
- 10) D
- 11) B
- 12) D
- 13) D
- 14) C
- 15) B
- 16) D
- 17) A
- 18) C
- 19) B
- 20) D
- 21) A
- 22) D
- 23) D
- 24) D
- 25) C
- 26) C
- 27) A
- 28) C
- 29) D
- 30) A
- 31) C
- 32) C
- 33) A
- 34) D
- 35) D
- 36) B
- 37) A
- 38) C
- 39) B
- 40) D
- 41) D
- 42) B
- 43) D
- 44) C
- 45) D
- 46) C
- 47) B
- 48) C

- 49) D
- 50) D
- 51) D
- 52) C
- 53) D
- 54) B
- 55) C
- 56) A
- 57) A
- 58) D
- 59) C
- 60) C